

Përfitueset e Programit të Vetë-Punësimit mbështesin përpjekjet në luftimin e koronavirusit në Kosovë

Në kohën kur jemi duke luftuar kundër pandemisë COVID-19, shumë prej nesh po gjejnë mënyra për të dhënë një kontribut, sado modest.

Lirije Mahmuti e cila drejton biznesin e saj të rrobaqepësisë në Podujevë ka qenë e regjistruar si punëkërkuese në zyrën e punësimit dhe është mbështetur përmes komponentës për vetë-punësim të Programeve të Tregut Aktiv të Punës 2 të UNDP-së. Që prej asaj kohe, ajo ka bërë çmos që të përkujdeset financiarisht për familjen e saj duke ofruar shërbime rrobaqepësie disa bizneseve lokale dhe organizatave të tjera. Me shfaqjen e pandemisë dhe kufizimin e lëvizjes edhe Liria ka zvogëluar punën e përditshme për të mbajtur familjen e saj të sigurt në shtëpi. Sidoqoftë, ajo është e përkushtuar të ndihmojë komunitetin dhe po e bën këtë duke qepur maska mbrojtëse për njerëzit e zonave rurale dhe urbane dhe Qendrën Mjekësore Familjare në komunën e Podujevës.

Edhe një përfituese tjetër e ALMP2, Magbule Ferati nga Fushë Kosova është duke qepur maska. Asaj iu desht të ndryshonte përparësitë e saj, të gjente një mënyrë për të mbijetuar në treg, por edhe të jepte kontributin e saj për qytetarët në komunën e saj.

"Është paksa e vështirë për mua në këtë kohë të gjej materiale të përshtatshme për prodhimin e maskave, por unë jam duke përdorur materiale të tjera që tashmë i kam në rezervë. Unë po qep maska edhe për fëmijë, në madhësi më të vogla", thot Ferati.

Këto dy gra janë ndër shumë përfituesit tjerë të Programeve Aktive të Tregut të Punës 2 të UNDP-së (ALMP2) dhe Agjencisë së Punësimit të Kosovës, të cilat po kontribuojnë gjatë kësaj kohe sfiduese për të ndihmuar komunitetin dhe për të mbajtur veten të sigurtë duke siguruar artikuj mbrojtës.

Programi i Vetë-Punësimit është pjesë e përpjekjeve gjithëpërfshirëse të Agjencisë së Punësimit në bashkëpunim me Programet Aktive të Tregut të Punës 2 të UNDP-së që synojnë promovimin e bizneseve që mund të mbijetojnë në treg konkurrues, ndërsa promovojnë vetë-punësimin si një masë aktive të tregut të punës dhe zhvillimin e sektorit privat dhe krijimin e vendeve të punës.

Për të mësuar më shumë rreth punës së ALMP2, ju lutemi shihni linkun: <http://bit.ly/2U7M4ZE>